

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 10/20), nenit 48-k të Statuti i Qytetit të Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 16/05, 8/10, 17/11, 18/13, 13/14, 1/15, 12/15, 4/19, 9/21 dhe 4/22) dhe nenit 1 të Vendimit për përcaktimin e nevojës për shpalljen e Thirrjes publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit ("Gazeta zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 2/26), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit

Iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj në Qytetin e Shkupit

1. Lënda e thirrjes publike

1.1. Lënda e thirrjes publike është përzgjedhja e anëtarëve për formimin e Këshillit Iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj në Qytetin e Shkupit, të cilët do të jenë pjesë e iniciativës për krijimin e Këshillit lokal rinor të Qytetit të Shkupit.

1.2. Këshilli iniciativ do të përbëhet nga tre (3) anëtarë.

1.3. Këshilli iniciativ ka këto detyra:

- të shpallë Thirrje publike për Kuvendin konstituiv të të rinjve në Qytetin e Shkupit, në pajtim me Statutin e Qytetit të Shkupit;

- të bashkëpunojë me Qytetin e Shkupit në organizimin, krijimin dhe konstituimin e Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit;

1.4. Këshilli iniciativ formohet me qëllim të konstituimit të Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit, ndërsa shpërndahe pas mbajtjes së seancës së parë konstituive të Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit.

2. Të drejtë për pjesëmarrje në thirrjen publike

Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e Qytetit të Shkupit të moshës nga 15 deri në 29 vjeç, të cilët janë anëtarë të organizatave rinore, organizatave për të rinj, forumeve rinore të partive politike, si dhe organizatave të nxënësve dhe studentëve dhe formave të tjera të organizimit rinor.

3. Kushtet për pjesëmarrje në thirrjen publike

3.1. Kushtet për aplikuesit – persona juridikë që nominojnë përfaqësuesin e tyre:

- të jenë shoqata rinore, organizata për të rinj, forume rinore të partive politike, bashkësi të shkollave të mesme ose studentore, shoqëri sportive, shoqëri kulturore-artistike dhe forma të tjera formale ose joformale të organizimit rinor;

- të jenë të regjistruar dhe/ose të veprojnë në territorin e Qytetit të Shkupit;

- të kenë interes për zhvillimin e organizimit rinor në nivel lokal;

- kandidatët e nominuar të jenë banorë të Qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Karposh, Kisella Vodë, Saraj, Qendër, Çair dhe Shuto Orizare);

- të jenë të moshës nga 15 deri në 29 vjeç;

- të jenë kreativë dhe të aftë për punë individuale dhe ekipore.

4. Dokumentacioni i nevojshëm

4.1. Për aplikantët – persona juridikë që nominojnë përfaqësuesin e tyre:

- Fletëparaqitje e plotësuar për propozimin e kandidatit për anëtar (fletëparaqitja do të publikohet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);

- Deklaratë e plotësuar për dhënien e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale të përfaqësuesit të nominuar (deklarata do të publikohet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);

- Deklaratë e plotësuar për pranimin e nominimit për zgjedhje si anëtar (deklarata do të publikohet në faqen zyrtare të Qyteti i Shkupit www.skopje.gov.mk);

- Portofol;

- Programi vjetor i punës;

- Raport mbi aktivitetet me të rinjtë gjatë vitit të fundit kalendarik;
- Dokument për gjendjen aktuale të regjistrimit të veprimtarisë, jo më i vjetër se gjashtë (6) muaj, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Letër e shkurtër motivuese dhe biografi e shkurtër (CV) e përfaqësuesit të nominuar.

5. Mënyra e zbatimit të thirrjes publike

- 5.1. Për zbatimin e procedurës sipas thirrjes publike, Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për zbatimin e Thirrjes publike për zgjedhjen e anëtarëve për formimin e Këshillit iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).
- 5.2. Fletëparaqitjet që janë të vonuara, të pakompletuara ose të plotësuara me dorë dhe që nuk i plotësojnë kushtet, Komisioni do t'i refuzojë me Konkluzion dhe do t'i njoftojë me shkrim aplikuesit.
- 5.3. Për fletëparaqitjet që janë të plota, të paraqitura me kohë dhe që i plotësojnë kushtet, Komisioni jep propozim deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit.
- 5.4. Me propozim të Komisionit, Kryetari i Qyteti i Shkupit sjell Vendim për formimin e Këshillit iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit.

6. Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjeve

- 5.1. Thirrja Publike publikohet në faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).
- 5.2. Thirrja Publike do të zgjasë pesë (5) ditë, duke filluar nga dita e publikimit.
- 5.3. Dokumentacioni i nevojshëm duhet të dorëzohet nga aplikuesit në zarf të mbyllur përmes Arkivit të Qytetit të Shkupit, çdo ditë pune, ose në adresën: bul. Ilinden nr. 82 – 1000 Shkup, me shënimin: "Për Komisionin për zbatimin e Thirrjes Publike për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit iniciativ për konstituimin e Kuvendit për të rinj të Qytetit të Shkupit".
- 5.4. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që mund të identifikojë aplikuesin.
- 5.5. Fletëparaqitja me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet në një kopje origjinale, e plotësuar në mënyrë elektronike, e nënshkruar dhe e vulosur nga personi përgjegjës i aplikuesit – personit juridik.
- 5.6. Informata plotësuese mund të merren në numrat e telefonit: 02/3297-238 dhe 02/3297-320.

QYTETI I SHKUPIT